



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:237065
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05608290

AC-I-23-0407-A0001 dhe A0002

Në ankesën e

Paditësi/Ankuesi

A0001 F I nga P i E, Komuna e Skenderaj.

Kundër

E paditura/Ankuesja

A0002 NSH "Trans Kosova" (në likuidim), të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurës të paraqitura kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-13-1547 të datës 13 qershor 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesat refuzohen si të pabazuara.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-13-1547, i datës 13 qershor 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 16 gusht 2013, paditësi parashtrori në DHPGJS një kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit MIT044-0007 të datës 18.07.2013 me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për kompensimin për paga të papaguara në shumën prej 15.904.00 euro për periudhën nga 01 tetori 2007, dhe kërkesë për kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, 5 paga mujore (400 euro-pagë mujore), në shumë prej 2.000 euro, si të pavlefshme me arsyetimin se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi se ai ka kryer ndonjë punë në NSH, si dhe dëshmi që këtë kërkesë e ka paraqitur para ndonjë gjykate apo organi kompetent që nga 01 tetori 2007. Në ankesë paditësi konsideron se Vendim i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit është i pa bazuar, pasi që ka qenë në regjistrin e pagave të punëtorëve, ka punuar në këtë ndërmarrje dhe kjo vërtetohet në bazë të dokumentacionit të paraqitur. Paditësi ka kërkuar që të anulohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, dhe ti aprovohet kërkesa si e bazuar. Me ankesë ka bashkangjitur Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, dhe Kontratën e punës, dhe një Vërtetim të AKP-së.

Me datë 28 maj 2014, AKP ka dorëzuar mbrojtjen e saj me të cilën pohon se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike përcjellë nga zbatimi i saktë i dispozitave të zbatueshme ligjore. AKP ka pohuar se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë argument ligjor kundër vendimit të AL-së, andaj ankesa është e papranueshme. Tutje ajo pohon se sa i përket vërtetimit të lëshuar nga AKP i datës 27 prill 2022 është lëshuar vetëm për qëllimet e krijimit e së drejtës së pensionit dhe jo për qëllime tjera. AKP pohon se kërkesa për paga për periudhën tetor 2007-maj 2011 është parashkruar në kuptim të nenit 608 të LPB-së, pasi që kërkesa nuk është dorëzuar brenda tri viteve në gjykatën kompetente. Andaj ka kërkuar që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Me datë 26 dhjetor 2017, paditësi ka dorëzuar përgjigjen në mbrojtjen e AKP-së, ku ka pohuar se pretendimet e AKP-së janë tërësisht të pabazuara dhe nuk kanë kurrfarë mbështetje ligjore dhe faktike dhe si të tilla kanë të vetmin synim të fshehjes nga e vërteta dhe ikjes nga përgjegjësia e obligimit të njohjes së drejtës sime. Pretendimi i AKP se kërkesa është parashkruar nuk qëndron. Paditësi ka pohuar se sipas një vendimi të NSH stafi menaxhues ka qenë i angazhuar deri sa

të mbyllet NSH-ja, dhe marrëdhënia e punës nuk më është shkëputur asnjëherë siç pretendon AKP-ja. Tutje ai pohon se me datën 17.02.2010 është kthyer pasuria e uzurpuar i cili fakt shihet me Marrëveshjen me KK Mitrovicë, ku është bërë lidhja e kontratës komerciale me qira me datë 23.02.2010. Lista përfundimtare për 20% ka qenë e datës 27.07.2012 çka do të thotë se ekziston një kontinuitet i pandërprerë i angazhimit tim si staf menaxhues i NSH-së. Padiësi pohon se me rastin e ushtrimit të ankesës ka dorëzuar kontratën e punës nr. 296, pasqyrat financiare, regjistrin e të ardhurave personale, vërtetimin që ka punuar nga 01.07.1971-30.05.2011.

Me datë 18 janar 2018, AKP ka dorëzuar kundërpërgjigjen me të cilën pohon se i konfirmon të gjitha qëndrimet dhe pohimet e parashtruara në mbrojtje. AKP pohon se në shkresat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi që provon se NSH-ja ka qenë ekonomikisht aktive pra se parashtruesi realisht ka ofruar shërbime për të dhe se detyrimi i NSH-së për të paguar parashtruesin ka lindur. Por edhe nëse detyrimi ka lindur ai është shuar përmes parashkrimit. AKP-ja po ashtu pohon se edhe lartësia e pretendimeve të parashtruesit, nuk është e bazuar në ndonjë dokument të besueshëm, dhe ajo e kundërshton atë. Andaj ka kërkuar që ankesa e ankuesit të refuzohet si e pabazuar.

Me datë 09 shkurt 2018, padiësi dorëzoi përgjigjen në kundërpërgjigjen e AKP-së. Në kundërpërgjigje ai ka pohuar se mbetet në tërësi pranë thënieve në përgjigjen e datës 22.12.2017 duke shtuar se arkiva e NSH-së gjendet tek AKP-ja dhe aty mund të shihet e gjitha. Padiësi ka pohuar se pretendimi i AKP se NSH nuk ka qenë aktive gjatë kësaj periudhe është i vërtet sepse NSH nuk ka qenë aktive si para luftës por aktivitetet e saj i ka ushtruar në kapacitetet që i ka pasur dhe këtë e vërtetojnë marrëveshjet e lidhura me KK Mitrovicë. Padiësi ka pohuar se gjatë asaj kohe ai ka lidhur kontrata komerciale me ndërmarrje tjera për shfrytëzimin e pasurisë së NSH-së, si dhënie e lokaleve me qira etj.

Me datë 16 korrik 2021, gjyqtari i çështjes përmes Urdhrit ka kërkuar nga padiësi prova shtesë në mbështetje të ankesës së tij të datës 16 shkurt 2013.

Me datë 03 gusht 2021, padiësi i përgjigjet Urdhrit të gjykatës dhe dorëzon një formular për pranimit-dorëzim të vulave të NSH-së të datës 03.06.2011, një

autorizim të lëshuar nga AKP me të cilin lejohet të vizitohen asetet e NSH-së i datës 07.07.2010, listën përfundimtare të 20% të NSH-së, kopjen e formularit për parashtrimin e kërkesave në likuidim të datës 08.08.2011, një kopje të regjistrit të pagesës së kompensimit për muajin prill 2010, i datës 21.04.2010, kopjen e marrëveshjes për shfrytëzim të lidhur mes Komunës së Mitrovicës dhe NTM "Transkosova" të datës 16.02.2010, kopjen e vlerësimit të komisionit të datës 17.02.2010 nr. 06, kopjen e kontratës Komerciale të datës 23.02.2010, kopjen e regjistrit të punëtorëve, kopjen e vërtetimit të lëshuar nga AKP me të cilin shihet se paditësi ka punuar në NSH nga data 01.07.1989 deri më 30.05.2011 (31 vite, 10 muaj, 29 ditë), kopjen e procesverbalit të rendit të ditës nr. 09 të datës 25.02.2010.

Me datë 13 qershor 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-13-1547 (2022:237065) e aprovon pjesërisht ankesën si të bazuar sa i përket dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe e ndryshon vendimin e Autoritetit të Likuidimit MIT044-0007 të datës 18.07.2013, e obligon të paditurën AKP që ankuesit në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës tia paguajë shumën prej 560 euro, dhe në emër të interesit ligjor shumën prej 10%, 56 euro, e refuzon ankesën si të pabazuar sa i përket kërkesës për kompensimin për paga të papaguara në shumë prej 15.904.00 euro dhe e vërteton vendimin e ankimuar të AL-së lidhur me këtë pjesë, si dhe obligon të paditurën AKP që të paguajë shpenzimet gjyqësore në shumë prej 30 euro. Shkalla e I-rë ka arsyetuar se në bazë të provave që ekzistojnë në lëndë, ankuesi ishte punëtorë i NSH-së në kohën e privatizimit të saj, dhe kështu i takon e drejta e në kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Në lidhje me shumën e aprovuar 560 euro, shkalla e parë ka marrë për bazë regjistrin e pagesës së kompensimit të ardhurave personale në shumë prej 80 euro të datës 21.04.2010.

Shkalla e parë ka konstatuar se në lidhje me kërkesën për paga të papaguara në shumë prej 15.904,00 euro, përtej shumës së aprovuar, paditësi nuk ka ofruar prova për ta mbështetur kërkesën për paga dhe si të tillë kjo kërkesë refuzohet si e pa bazuar. Shkalla e I-rë konstaton se paditësi as në procedurën e likuidimit dhe as me ankesë në shkallën e I-rë nuk i ka mbështetur me prova materiale pretendimet për borxhin e kërkuar lidhur me pagat e papaguara, duke konstatuar se paditësi nuk ka saktësuar saktë as periudhën për të cilën i kërkon pagat ndaj

NSH-së. Andaj nga këto arsye ankesa lidhur me pagat e pretenduara ndaj NSH-së është refuzuar si e pa bazuar.

Me datë 03 korrik 2023, paditësi për mes postës(në tekstin e mëtejme ankuesi) ka parashtruar ankesë ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së C-IV-13-1547 të datës 13.06.2023 për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedural, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Ankuesi ka pohuar se Aktgjykimi i ankimuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi i Aktvendimit është i pakuptim dhe kontradiktor me vetveten, nuk janë dhënë fare arsye mbi faktet vendimtare. Tutje ankuesi ka pohuar se pagesa për muajin prill në fakt është një pjesë e akontacionit e marrë nga qiraja, e jo rroga sepse rroga për paditësin në cilësinë e drejtorit ka qenë 400 euro. Ankuesi edhe me ankesë ka përsëritur pretendimet e tij të dhëna pranë shkallës së parë, duke pohuar se kërkesa nuk mund të konsiderohet si e parashkruar. Ankuesi ka kërkuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, të anulohet Aktgjykimi i ankimuar, si dhe ti aprovohet shuma e kërkuar në emër të pagave të papaguara.

Me datë 07 korrik 2023, AKP (në tekstin e mëtejme ankuesja) ka paraqitur ankesë ndaj Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së C-IV-13-1547 të datës 13.06.2023. AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën për paga të papaguara për parashtruesin pasi ky ka rezultuar të mos ishte aktiv në momentin kur filloi likuidimi dhe rrjedhimisht duke qenë se nuk ishte në një marrëdhënie pune aktive me NSH-në në momentin kur hyri në likuidim nuk kishte se si marrëdhënia e tij e punës të ndërpritej nga një veprim i ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit 04/L-034. AKP ka kërkuar që të merren në konsideratë argumentet ligjore të ngritura dhe të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, duke refuzuar ankesën e paditësit të paraqitur kundër Vendimit MIT044-0007 të datës 18.07.2013, si të pabazuar dhe të vërtetoj Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 04 shtator 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtesë dhe i përgjigjet ankesës së paditësit. Në këtë parashtesë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet pjesa refuzuese e Aktgjykimit të ankimuar të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka

pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 01 shtator 2023, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë dhe përgjigjet në ankesën e AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të AKP-së duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. Paditësi pohon se AKP-ja të vetmin synim e ka prolongimin e kërkesës së paditësit, dhe shmangëjën nga përgjegjësia për të përmbushur obligimet që i ka ndaj paditësit, pagesën në emër të ardhurave personale për periudhën e cekur prej 15.904.00 euro, dhe 2000 euro për 5 paga të papaguara. Paditësi në këtë parashtresë i është referuar provave që i ka dorëzuar në gjykatë, duke pohuar se stafi menagjues ka qenë i angazhuar, deri sa i është vënë dryni ndërmarrjes ,ku ai ka punuar. Tutje paditësi pohon se ndjehet i diskriminuar për mos pagesën e të ardhurave personale për periudhën 2007-2011, e cila e drejtë i garantohet me Kushtetutë dhe Konventa ndërkombëtare. Nga këto arsye paditësi ka kërkuar që të refuzohet ankesa e AKP-së si e pabazuar, dhe atij ti njihet e drejta në paga të papaguara për periudhën e cekur.

Arsyetimi ligjor:

Ankesat refuzohen si të pabazuara.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 08 gusht 2011, e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit dhe ka kërkuar që ai të kompensohet për pagat e pa paguara për periudhën nga 01 tetori 2007 në shumë prej 15.904,00 euro, si dhe

kërkesë për dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën prej 2.000,00 euro.

Këto kërkesa me vendimin e ankimuar ishin refuzuar nga Autoriteti i Likuidimit, me arsyetimin se paditësi nuk ka bashkangjitur asnjë provë për të mbështetur pretendimet e tij, si dhe kërkesat janë parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë e ka aprovuar pjesërisht ankesën sa i përket kërkesës për dëmshpërblimin për ndërprerje të kontratës së marrëdhënies së punës shumën prej 560,00 euro, duke marrë për bazë regjistrin e pagesës së kompensimit në emër të ardhurave personale për muajin prill 2010, në shumë prej 80 euro. Ndërsa sa i përket pjesës tjetër të kërkesës lidhur me paga të papaguara për periudhën e paspecifikuar në shumë prej 15.904,00 euro, e ka refuzuar si të pabazuar, me arsyetimin se paditësi ka dështuar të sjellë prova të mjaftuara për ta mbështetur kërkesën për paga të papaguara të pretenduara ndaj NSH-së.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në Shkallën e I-rë ka sjell një formular për pranidorëzim të vulave të NSH-së të datës 03.06.2011, një autorizim të lëshuar nga AKP-ja me të cilin lejohet të vizitohen asetet e NSH-së i datës 07.07.2010, listën përfundimtare të 20% të NSH-së, kopjen e formularit për parashtrimin e kërkesave në likuidim të datës 08.08.2011, një kopje të regjistrit të pagesës së kompensimit për muajin prill 2010, i datës 21.04.2010, kopjen e marrëveshjes për shfrytëzim të lidhur mes Komunës së Mitrovicës dhe NTM "Transkosova" të datës 16.02.2010, kopjen e vlerësimit të komisionit të datës 17.02.2010 nr.06, kopjen e kontratës Komerciale të datës 23.02.2010, kopjen e regjistrit të punëtorëve, kopjen e vërtetimit të lëshuar nga AKP-ja me të cilin shihet se paditësi ka punuar në NSH nga data 01.07.1989 deri më 30.05.2011 (31 vite, 10 muaj, 29 ditë), kopjen e procesverbalit të rendit të ditës nr. 09 të datës 25.02.2010.

Bazuar në këto prova, Kolegji i Apelit konsideron se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me të drejtë e kishte aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit lidhur me kërkesën për kompensim për ndërprerje të parakohshme të Kontratës së punës në shumë prej 560,00 euro, dhe e kishte ndryshuar lidhur me këtë kërkesë vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, duke detyruar AKP-në që të paguaj shumën 560 euro

për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, e cila shumë do të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit konstaton se paditësi mjaftueshëm ka vërtetuar me prova se ishte punëtor i NSH-së në kohën e privatizimit të saj, dhe bazuar në këtë fakte atij i takon e drejta në kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës.

Kolegji i Apelit bazuar në vërtetimin e AKP-së, të cilën ia ka lëshuar paditësit shihet se paditësi ka punuar në NSH nga data 01.07.1989 deri më 30.05.2011 (31 vite, 10 muaj, 29 ditë), që do të thotë se në bazë të nenit 76.7.7.5 të Ligjit të Punës 03/L-212 atij i takojnë 7 paga nga 80 euro, ose në shumë prej 560,00 euro.

Paditësi në ankesën e tij të dorëzuar pranë Kolegjit të Apelit ka pohuar se pagesa e muajit prill të vitit 2010 në shumë prej 80 euro është një pjesë e akontacionit e marrë nga qiraja e jo paga, sepse paga e tij ka qenë në shumë prej 400 euro.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në ankesën e tij përveç aspektit deklarativ me asnjë provë nuk e ka mbështetur pohimin e tij se paga e tij ka qenë 400 euro, andaj Kolegji i Apelit e merr si pagë të realizuar shumën prej 80 euro nga regjistri i kompensimit të muajit prill 2010.

Bazuar në nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, paditësit me të drejtë i është aprovuar edhe interesi ligjor prej 10%, në shumën e aprovuar të borxhit, ose 56,00 euro, e cila duhet të paguhet sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit.

Po ashtu Kolegji i Apelit pajtohen me pohimin e paditësit se kërkesa e tij lidhur me pagat e papaguara, megjithëse nuk i kishte specifikuar deri kur i kërkon pagat, tërësisht nuk është e parashkruar.

Paditësi tek Autoriteti i Likuidimit i ka kërkuar pagat nga 01 tetor 2007, ndërsa nuk specifikon deri në cilën periudhë i kërkon pagat ndaj NSH-së. AKP-ja me mbrojtje në ankesë i referohet periudhës tetor 2007-maj 2011, dhe këtë fakt nuk e ka

kontestuar paditësi, ashtu që mund të konsiderohet se kjo ishte periudha për të cilën paditësi i kërkon pagat ndaj NSH-së.

Marrë parasysh se kërkesa tek Autoriteti i Likuidimit është paraqitur me datë 08 gusht 2011, atëherë dele që pagat nga muaji gusht 2008-gusht 2011, nuk mund të konsiderohen të parashkuara, siç konstaton në mënyrë të gabuar Autoriteti i Likuidimit, kurse pagat e periudhës së mëhershme janë parashkuar.

Megjithatë në këtë lëndë paditësi ka dështuar të sjellë prova të mjaftuar për ti mbështetur pretendimet e tij për paga. AKP-ja me mbrojtje në ankesë për veç parashkrimit të kërkesës, ajo e konteston edhe lartësinë e kërkesës për paga, duke pohuar se paditësi nuk ka ofruar prova që vërtetojnë shumën e kërkuar në emër të pagave të papaguara.

Në bazë të nenit 42.2 të LDHP-së dhe nenit 7 të LPK-së, barra e provës bie mbi paditësin, ai është i detyruar ti mbështesë pretendimet e tij lidhur me pagat e kërkuara ndaj NSH-së. Provat të cilave u referohet paditësi në ankesën e tij nuk janë të mjaftuara për të ja njohur të drejtën në paga, pasi që këto prova nuk vërtetojnë as periudhën dhe as lartësinë e kërkuar të borxhit në emër të pagave të papaguara.

Prandaj nga këto arsye, me të drejtë shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka refuzuar pjesërisht ankesën e paditësit lidhur me pagat e kërkuara nga paditësi, dhe e ka vërtetuar në këtë pjesë Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, rezultati i dhënë me aktgjykimin e ankimuar nuk ka mundësi të ndryshohet, andaj refuzohen si të pa bazuara ankesa e paditësit dhe ankesa e AKP-së, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Paditësi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore në shumën prej 30 euro, me datën 07 gusht 2023, ndërsa AKP-ja në shumë prej 100 euro me datë 26 korrik 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues _____